



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:147671
Datë: 21.10.2024
Numri i dokumentit: 06327454
C.nr.1373/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.K. me numër personal R.B. me numër personal I.E. me numër personal dhe H.K. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurve: K.P.-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, dhe M.A.Sh.T. dhe Inovacionit në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 9,840.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 21.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve: A.K., R.B., I.E. dhe H.K. që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, t'iu paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit A.K. për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro dhe për 18 ditë shumën prej 33.21 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,859.76 euro.
- Paditëses R.B. për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej 19% të pagës bazë- 421.00 euro dhe për 18 ditë shumën prej 23.37 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,308.72 euro.
- Paditësit I.E. për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro dhe për 18 ditë shumën prej 33.21 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,859.76 euro.
- Paditësit H.K. për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro dhe për 18 ditë shumën prej 33.21 euro, në emër të

diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,859.76 euro.

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 07.07.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve A.K., R.B., I.E. dhe H.K. kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 9,840.00 euro, përkatësisht në shumën prej 2,952.00 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 30.06.2018.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve A.K., R.B., I.E. dhe H.K. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 320.00 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm

V. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.1373/2021 e paditësve: A.K., R.B., I.E. dhe H.K. kundër të paditurve: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në Prishtinë, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

A r s y e t i m

Paditësit: A.K., R.B., I.E. dhe H.K. që të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurve: Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

Me parashtrësën e datës 30.10.2023 i autorizuari i paditësve av. V.H. ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv duke përfshirës të paditure edhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe duke precizuar kërkesëpadinë prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 dhe shumën e kërkesë për secilin paditës e në shumë të përgjithshme prej 9,840.00 euro

Me parashtrësën e datës 26.10.2023, i autorizuari i paditësve ka hequr dorë nga kërkesëpadija edhe ndaj të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Në padi, paditësit kanë theksuar se janë të punësuar pranë SHFMU "Brigada 125" në fshatin Medvec, komuna e Prizrenit dhe atyre nuk i është paguar në tërësi shtesa mbi bazën e kualifikimit. Pasi që paditësit: A.K., I.E. dhe H.K. janë të kualifikuar me nivelin Fakultet-Bachelor, iu është e garantuar pagesa shtesë prej 27% në pagën bazë, ndërsa paditëses :R.B. është e garantuar pagesa shtesë prej 19% në pagën bazë, të cilën e paditura ia ka paguar, por jo plotësisht. Andaj, ka kërkuar që të detyrohet e paditura në kompensimin e shumës së lartcekur nga data 18.04.2017 e deri më 18.04.2021, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Me parashtrësën e datës 31.10.2023, i autorizuari i paditësit përfundimisht ka precizuar kërkesëpadinë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar që paditësve: A.K., I.E. dhe H.K. i t'iu kompensohet secilit veç e veç shuma prej 2,892.00 euro, ndërsa, t'iu kompensohet secilit veç e veç shuma prej 2,892.00 euro, ndërsa paditëses R.B. shuma prej 1,869.60 euro me kamatë ligjore dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

E paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

E paditura: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në përgjigjen në padi kanë theksuar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, pasi që atyre iu mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në procedurë. Andaj, kanë propozuar që të refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit ndaj këtyre të paditurve.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të datës 31.10.2023, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjeve në padi të paraqitur nga ana e të paditurve, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar ndaj të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, andaj pa shqyrtim të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, si mësimdhënës pranë SHFMU “Brigada 125” në fshatin Medvec, komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës për paditësin Asim Kastrati dhe diploma nr. 676 e datës 22 prill 2016, vërtetoi se kualifikimi i paditësit është Bachelor i programit fillor.

Nga kontrata e punës për paditësin R.B. dhe diploma nr. 949 e datës 30 dhjetor 2010, gjykata vërtetoi se kualifikimi i paditësit është shkollim i lartë pedagogjik- arsimtare e matematikës.

Nga kontrata e punës për paditësit I.E. dhe diploma nr. 568 e datës 04.04.2016, gjykata vërtetoi se kualifikimi i paditësit është Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze.

Nga kontrata e punës për paditësin H.K. dhe diploma nr. 48 e datës 17.07.1997, gjykata vërtetoi se kualifikimi i paditësit është Fakulteti Filologjik –Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të të gjithë paditësve është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësve: A.K., I.E. dhe H.K. në emër të kualifikimit Fakultet apo diplomë universitare 3 apo 4 vjeçare, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro, ndërsa paditëses R.B. në emër të kualifikimit Shkollim i Lartë Pedagogjik, program mësimor 2 vjeçare, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 41.04 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit ka për detyrim, që paditësve t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve: A.K., I.E. dhe H.K. ia ka paguar shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditëses R.B. ia ka paguar shuma prej 41.04 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 dhe 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit: A.K., I.E. dhe H.K. përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro, ndërsa paditësja:

R.B. përfiton ngritje prej 19 % të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 79.99 euro

Së këndejmi, gjykata vendosi që paditësve: A.K., I.E. dhe H.K. iu takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 421.00 euro apo në shumë prej 55.35 euro, ndërsa paditëses: R.B. diferenca në shumë prej 38.95 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve: A.K., I.E. dhe H.K. për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 55.35 euro, për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune, secilit veç e veç shumë e përgjithshme prej 1,859.76 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 55.35 euro, duke e shumëzuar për 33 muaj ($33 \times 55.35 = 1,826.55$ euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 18 ditë ($1.845 \times 18 = 33.21$ euro) apo në mënyrë të përmbledhur ($1,826.55 + 33.21 = 1,859.76$ euro). Ndërsa, paditëses : R.B. për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 38.95 euro, për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 33 muaj e 18 ditë pune, shumë e përgjithshme prej 1,308.72 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 38.95 euro, duke e shumëzuar për 33 muaj ($33 \times 38.95 = 1,285.35$ euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 18 ditë ($1.298 \times 18 = 23.37$ euro) apo në mënyrë të përmbledhur ($1,285.35 + 23.37 = 1,308.72$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.07.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 07.07.2021, ndërsa kërkesa e tyre ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 01.07.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar në shumë prej 2,952.00 euro, bazuar në shumë e kërkuar nga pala paditëse dhe pjesës aprovuese sipas arsyeve të theksuara më lartë.

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 07.07.2021 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2018 e deri më 18.04.2021, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin korrik 2018, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin korrik 2018 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimi të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e kualifikimit për muajin korrik 2018 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht gusht 2018, e njëjta ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur K.P.-Drejtoria Komunale e Arsimit dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi si në pikën nën V. të aktgjykimit, pasi që me parashtrësën e datës 31.10.2023, përkatësisht 26.12.2023, i autorizuari i paditësve ka tërhequr padinë kundër të paditurve: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike. Andaj, në përputhje me nenin 261 të LPK-së, gjykata e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësve ndaj të paditurve të lartcekur.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën K.P.-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 320.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 260.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 60.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet prej 260 € për precizimin të padisë, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësia gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 261, 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1373/2021, datë 21.10.2024

Gjyqtari,
Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.